

**LIGJI Nr. 04/L-164  
PËR ANSAMBLIN KOMBËTAR TË KËNGËVE DHE VALLEVE "SHOTA"  
DHE PËR ANSAMBLET E TJERA**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR ANSAMBLIN KOMBËTAR TË KËNGËVE DHE VALLEVE "SHOTA"  
DHE PËR ANSAMBLET E TJERA**

**KREU I  
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi i Ligjit**

Ky ligj përfshinë rregullimin e veprimtarisë kulturore-artistike, përgatitjen e shfaqjeve, veprave koreografike, këngëve, valleve dhe vlerave të trashigimisë shpirtërore materiale.

**Neni 2  
Fushëveprimi i ligjit**

Me këtë ligj rregullohet funksionimi i veprimtarisë kulturore dhe artistike të Ansambllit kombëtar të këngëve dhe valleve "Shota" dhe të ansambleve të tjera, llojet, themelimi, organizimi, financimi, pozita e artistëve dhe çështje të tjera të kësaj veprimtarie.

**Neni 3  
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Ansambli "Shota"** - Ansambël kombëtar i këngëve dhe valleve, (në tekstin e mëtejme Ansambli "Shota" ) që ka si objekt të veprimtarisë së vet, zhvillimin e artit skenik, ruajtjen e trashëgimisë kulturore-shpirtërore, realizimin e vlerave skenike, zhvillimin dhe kultivimin e vlerave etnomuzikologjike e etnokoreografike si dhe promovimin e tyre brenda dhe jashtë vendit.

1.2. **Ansamblet Komunale** - shoqëri kulturore-artistike publike, veprimtaria e të cilave ka për qëllim realizimin e aktiviteteve kulturore që shprehën me këngë, valle dhe koreografi të cilat ruajnë dhe kultivojnë traditën, doket dhe zakonet.

1.3. **Ansamblet Private** - organizata joqeveritare dhe organizata profitabile, të cilat /zhvillojnë veprimtarinë e tyre në bazë të statutit të tyre.

1.4. **Trupa Artistike** - emërtim për stafin udhëheqës artistik, valltarët, solistët vokal dhe orkestrën.

1.5. **Fondusi** - tërësia e kostumeve, instrumenteve, muzikore, rekuizitave, elementeve skenografike si dhe mjeteve e materialeve tjera me vlera etnomuzikologjike.

## **KREU II LLOJET, THEMELIMI, VEPRIMTARIA, ORGANIZIMI, FINANCIMI DHE STATUSI I ARTISTËVE**

### **Neni 4 Llojet e Ansambleve**

1. Ansamblet mund të jenë : publike dhe private.

1.1. Ansamblet publike janë :

1.1.1. Ansambli kombëtar i këngëve dhe valleve “Shota”;

1.1.2. Ansamblet komunale.

1.2. Ansamblet private.

### **Neni 5 Themelimi i Ansambleve**

1. Ansambli “Shota” është Institutucion kombëtar i kulturës i themeluar nga Kuvendi i Kosovës.

2. Ansamblet komunale themelohen me vendim të Asamblesë komunale.

3. Ansamblet private mund të themelohen nga personat fizik dhe juridik në bazë të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.

### **Neni 6 Veprimtaria e Ansambleve**

1. Veprimtaria e Ansambleve përfshinë:

1.1. ruajtjen e traditës muzikore kombëtare;

1.2. shfaqjen publike të koncerteve dhe të formave tjera skeniko- muzikore;

1.3. organizimin dhe realizimin e Koncerteve të traditës shpirtërore;

1.4. konzervimin dhe arkivimin e lëndës muzikore të traditës shpirtërore e materiale, si dhe nxitjen, zhvillimin, avancimin, publikimin dhe promovimin e artit kombëtarë brenda dhe jashtë vendit;

1.5. pergaditjen, ngritjen, promovimin, edukimin e kuadrove të reja .

**Neni 7**  
**Organizimi i Ansambllit "Shota"**

1. Ansambli "Shota" është Institucion kombëtar i kulturës i cili e ka selinë në Prishtinë.
2. Ansambli "Shota" ka simbolet e veta identifikuese.
3. Organizimi dhe funksionimi i Ansambllit "Shota" rregullohet me statut dhe akte të tjera nënligjore në pajtim me këtë ligj.
4. Struktura organizative e Ansambllit "Shota" përbëhet nga:
  - 4.1. Këshilli drejtues;
  - 4.2. Drejtori;
  - 4.3. Këshilli artistik;
  - 4.4. Udhëheqësi artistik;

**Neni 8**  
**Këshilli drejtues i Ansambllit "Shota"**

1. Këshilli drejtues përbëhet prej pesë (5) anëtarëve me mandat katër (4) vjeçar, të cilët preferohet të jenë nga fusha e Arteve Skeniko-Muzikore dhe Etnomuzikologjike.
2. Këshillin drejtues të Ansambllit "Shota" e emëron, e konstituon dhe e shkarkon Ministri përkatës për kulturë.
3. Njeri prej pesë (5) anëtarëve duhet të jetë përfaqësues i Ministrisë përkatëse për kulturë pa të drejtë që të zgjedhet kryetar i këshillit.
4. Kryetari i Këshillit drejtues zgjedhet në mbledhjen e parë me shumicë të votave.
5. Antarët e Këshillit drejtues për punën e tyre kompenzohen. Forma dhe shuma e pagesës përcaktohet me akt nënligjor nga Ministri.

**Neni 9**  
**Detyrat dhe Përgjegjësitë e Këshillit Drejtues**

1. Këshilli drejtues ka këto detyra dhe përgjegjësi:
  - 1.1. harton statutin e Ansambllit "Shota" të cilin e miraton Ministria përkatëse për Kulturë;
  - 1.2. harton dhe aprovon politikën zhvillimore të Ansambllit "Shota";
  - 1.3. aprovon planin vjetor të punës dhe planin financiar vjetor të Ansambllit "Shota";
  - 1.4. aprovon raportin vjetor të punës dhe Raportin financiar të Ansambllit "Shota";
  - 1.5. harton dhe miraton rregullorën e punës së vet;

- 1.6. e zgjedh dhe e shkarkon Drejtorin e Ansambllit "Shota";
- 1.7. zgjedh dhe e shkarkon Udhëheqësin artistik;
- 1.8. për punën e vet i raporton dhe i përgjigjet Ministrin përkatës për kulturë;
- 1.9. në konsultim me Drejtorin dhe Udhëheqësin artistik, harton rregulloret e nevojshme për funksionimin e Ansambllit.

#### **Neni 10 Drejtori i Ansambllit**

1. Drejtori i Ansambllit "Shota" është udhëheqës i Ansambllit dhe organ ekzekutiv.
  - 1.1. Drejtori i Ansambllit "Shota" zgjedhët me konkurs publik të shpallur nga Ministria përkatëse për kulturë;
  - 1.2. Drejtori duhet të ketë diplomë universitare në fushën e artit dhe të kultures, si dhe me përvojë pune në këtë fushë;
  - 1.3. mandati i Drejtorit është katër (4) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes.

#### **Neni 11 Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit.**

1. Drejtori i Ansambllit udhëheqë, organizon, mbikqyr veprimtarinë dhe funksionimin e Ansambllit.
2. I propozon dhe raporton Këshillit drejtues planin vjetor të punës dhe planin vjetor financiar.
3. Merr pjesë në mbledhjet e Këshillit drejtues pa të drejtë vote.
4. Përfaqëson Ansamblin brenda dhe jashtë shtetit.
5. Kërkon dhe negocion marrjen e donacioneve si dhe përgjigjet për to.
6. Informon me shkrim Drejtorin e departamentit të kulturës së Ministrisë përkatëse për kulturë për punën javore të Ansambllit.
7. Ushtron detyra dhe përgjegjësi tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 12 Këshilli artistik i Ansambllit "Shota "**

1. Këshilli artistik ka pesë (5) anëtarë dhe përbëhet nga:
  - 1.1. Udhëheqësi artistik i Ansambllit;
  - 1.2. Koreografi;
  - 1.3. Koreopetitori;
  - 1.4. Përgjegjësi i seksionit të solistëve vokal;

- 1.5. Përgjegjësi i seksionit të orkestrës.
2. Udhëheqësi Artistik është kryesues i Këshillit artistik.

**Neni 13**  
**Detyrat dhe Përgjegjësitë e Këshillit Artistik**

1. Këshilli Artistik i Ansambllit „Shota“ ka këto detyra:
  - 1.1. harton dhe i propozon Drejtorit, programin artistik vjetor të Ansambllit;
  - 1.2. bën vlerësimin artistik të koncerteve dhe të aktiviteteve të tjera kulturore si dhe jep sugjerime për konceptin e programit të Ansambllit;
  - 1.3. miraton programet e shfaqjeve artistike.
  - 1.4. përkujdesjet për prezentimin e vlerave të trashëgimisë shpirtërore e material;
  - 1.5. vlerëson dhe miraton pikat premierë të programit;
  - 1.6. bën vlerësimin profesional të valltarëve, solistëve vokal dhe instrumentistëve për çdo dy (2) vjet.

**Neni 14**  
**Udhëheqësi artistik i Ansambllit**

1. Udhëheqësi artistik i Ansambllit është person përgjegjës profesional i Ansambllit, me përgatitje profesionale universitare në fushën e arteve skenike- muzikore.
2. Udhëheqësi artistik i ansambllit zgjedhet me konkurs publik të shpallur nga Ministria përkatëse për kulturë.
3. Udhëheqësi duhet të ketë përgatitje universitare në fushën e artit dhe të kultures si dhe me përvojë pune në këtë fushë.
4. Mandati i udhëheqësit artistik është katër (4) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes.

**Neni 15**  
**Detyrat dhe përgjegjësitë e udhëheqësit artistik**

1. Zbaton programin artistik vjetor të ansambllit "Shota" dhe koordinon me programet e koncerteve.
2. Udhëheq punën e Këshillit artistik.
3. Udhëheqësi artistik i Ansambllit për punën e tij i përgjigjet dhe i raporton Drejtorit të Ansambllit dhe përmes tij Këshillit drejtues.

**Neni 16**  
**Organizimi i Ansambllit komunal**

1. Organizimi dhe funksionimi i Ansambllit Komunal rregullohet me statut dhe akte të tjera nënligjore në pajtim me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi e të miratuara nga Asambleja komunale.

2. Struktura organizative e Ansambllit komunal përbëhet nga:

2.1. Drejtori; dhe

2.2. Këshilli artistik.

#### **Neni 17**

##### **Drejtori i Ansambllit komunal**

1. Drejtori i Ansambllit komunal është udhëheqës i Ansambllit.

1.1. Drejtori zgjedhet me konkurs publik nga drejtorja përkatëse për kulturë e Komunës përkatëse;

1.2. Drejtori duhet të ketë diplomë universitare në fushën e artit dhe të Kulturës, si dhe me përvojë në këtë fushë;

1.3. mandati i Drejtorit është katër (4) vjeçar me mundësi të rizgjedhjes.

#### **Neni 18**

##### **Detyrat dhe përgjegjësit e drejtorit të Ansambllit komunal**

1. Drejtori i Ansambllit udhëheqë, organizon, mbikqyrë veprimtarinë dhe funksionimin e Ansambllit.

2. I propozon dhe raporton për planin vjetor të punës dhe planin vjetor financiar drejtorisë përkatëse për kulturë.

3. Kërkon dhe negocion për marrjen e donacioneve.

4. Ushtron detyra dhe autorizime tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 19**

##### **Këshilli artistik i Ansambllit komunal**

1. Këshilli artistik ka tre (3) ose pesë (5) anëtarë të cilët vijnë nga radhet e Ansambllit.

2. Këshilli artistik nga radhët e veta zgjedh kryesuesin, me shumicë të votave.

#### **Neni 20**

##### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit artistik të Ansambllit komunal**

1. Këshilli artistik i Ansambllit Komunal ka për detyrë:

1.1. të hartojë, shqyrtojë dhe propozojë Drejtorit programin artistik vjetor të Ansambllit;

1.2. të bëjë vlerësimin artistik të koncerteve dhe të aktiviteteve të tjera kulturore si dhe ofron sugjerime për konceptin e programit të Ansambllit;

1.3. miraton programin artistik të Ansambllit;

1.4. të bëjë përkujdesjen për prezentimin e vlerave të trashëgimisë shpirtërore materiale.

**Neni 21**  
**Organizimi i Ansambleve private**

1. Ansamblet, shoqëritë dhe grupet artistike private udhëheqen nga Drejtori.
2. Drejtori emërohet në pajtim me kushtet e përcaktuara me statut.
3. Statuti dhe aktet tjera nënligjore miratohen në pajtim me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi .

**Neni 22**  
**Financimi i Ansambilit “Shota”**

1. Ansambli “Shota” financohet nga Ministria përkatëse për Kulturë.
2. Ansambli “Shota”ka kod të veçantë buxhetor dhe i menaxhon vetë financat e veta.
3. Ansambli “Shota” financohet dhe nga burimet tjera financiare në pajtim me legjislacionin në fuqi.

**Neni 23**  
**Financimi i Ansambleve komunale**

1. Ansambli komunal financohet nga buxheti i Komunës.
2. Ansambli komunal mund të konkurojë me projekte, për mbështetje financiare në konkursin vjetor të projekteve kulturore në Ministrinë përkatëse për kulturë.
3. Ansambli komunal financohet edhe nga burimet tjera financiare në pajtim me legjislacionin në fuqi.

**Neni 24**  
**Financimi i Ansambleve private**

1. Ansamblet private financohen nga themeluesi dhe format tjera të financimit.
2. Ansamblet private mund të konkurojnë me projekte për mbështetje financiare në drejtorinë përkatëse për kulturë si dhe në konkursin vjetor për projekte kulturore në Ministrinë përkatëse për kulturë.
3. Zbatimi i këtij ligji mund të bëhet varësisht nga situata fiskale dhe buxhetore.

**Neni 25**  
**Statusi i artistëve**

1. Trupa artistike e Ansambilit “Shota” është trupë profesionale.
2. Trupa artistike e Ansambilit “Shota” përbëhet nga:
  - 2.1. stafi udhëheqës artistik i përbërë nga: udhëheqësi artistik, koreografi, koreopetitori, dy (2) përgjegjësit e seksioneve të solistëve vokal dhe orkestrës;

- 2.2. valltarët, instrumentistët, solistët vokal;
- 2.3. ispicienti, garderobieri;
- 2.4. trupa artistike e Ansambilit "Shota" punon me orar të shkurtuar;
- 2.5. këshilli Artistik është i obliguar të bëjë vlerësimin profesional të valltarëve, solistëve vokal dhe instrumentistëve çdo dy (2) vjet;
- 2.6. mënyra e vlerësimit profesional do të bëhet me rregullore e cila hartohet nga Këshilli drejtues në bashkëpunim me Këshilli Artistik dhe miratohet nga Ministria përkatëse për Kulturë.

**Neni 26**  
**Stazhi i beneficuar i Ansambilit "Shota"**

1. Moshë e pensionimit për valltarët e gjinisë mashkullore, është pesëdhjetë (50) vjet.
2. Moshë e pensionimit për valltarët e gjinisë femrore, është dyzet e pesë (45) vjet.

**Neni 27**  
**Lënda Arkivore**

1. Ansambli kombëtar "Shota" obligohet që ta ketë arkivën e vet, ku duhet të ruaj, pasuroj dhe kultivoj lëndën arkivore.
2. Nëse Ansambli "Shota" pushon së funksionuari, dokumentacioni dhe lënda arkivore në pajtim me dispozitat e Ligjit 04/L-088 për Arkivat shtetërore i dorëzohen për ruajtje Agjencionit shtetëror të arkivave.

**Neni 28**  
**Fondusi**

1. Ansambli "Shota" dhe ansamblet tjera kanë fondusin e vet dhe janë të obliguar që t'i ruajnë kostumet, instrumentet muzikore, rekuizitat, elementet skenografike si dhe materialet e tjera me vlera etnomuzikologjike.
2. Nëse Ansambli "Shota" pushon së funksionuari, kostumet origjinale, rekuizitat, instrumentet muzikore dhe materialet e tjera me vlerë artistike, kalojnë në pronësi të Muzeut etnologjik të Kosovës.

**KREU III**  
**DISPOZITAT SHFUQIZUESE DHE PËRFUNDIMTARE**

**Neni 29**  
**Aktet nënligjore**

1. Ministria përkatëse për Kulturë nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e ligjit për Ansamblin "Shota" dhe për ansamblet tjera brenda gjashtë (6) muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Ansambli "Shota" dhe ansamblet tjera duhet që në afat prej gjashtë (6) muajsh të bëjnë harmonizimin e akteve të tyre normative me këtë ligj.



**Neni 30**  
**Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të ligjit për Ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve "Shota" dhe për ansamblet e tjera, shfuqizohet Ligji Nr.03/L-056 për Ansamblin kombëtar shtetëror të këngëve dhe valleve "Shota" dhe për ansamble tjera.

**Neni 31**  
**Hyrja në Fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/L-164**  
**28 mars 2013**

**Ligji shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës duke u bazuar në nenin 80 paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.**